



Mirë se vini në Swedbank dhe në bankat e kursimeve

Për t'u regjistruar si klient i Swedbank ose i një banke kursimi, duhet të paraqisni një dokument identifikues dhe të shpjegoni se pse ju nevojitet një llogari bankare. Ky është një udhëzues për informacionet që ju nevojitet t'i paraqisni bankës kur vini te dega e bankës.

Identifikimi

Nëse keni numër identifikimi personal suedez

Nëse keni numër identifikimi personal suedez, duhet të paraqisni një dokument identifikues të vlefshëm suedez.

Nëse nuk keni numër identifikimi personal suedez

Nëse nuk keni numër identifikimi personal suedez, duhet të paraqisni një pasaportë të vlefshme kombëtare që tregon nënshtetësinë tuaj.

Për vendet që janë pjesë e Marrëveshjes Schengen, është e vlefshme gjithashtu ekuivalentja e kartës suedeze kombëtare të identitetit ku tregohet kombësia juaj.

Nëse paraqisni një dokument identifikimi të huaj, identiteti juaj duhet të vërtetohet me anë të një dokumenti shtesë, si p.sh. leja e qëndrimit, deklarata e punësimit, një certifikatë nga zyra e taksave apo certifikata e shkollës.

Nëse nuk kuptoni suedisht apo anglisht

Nëse nuk kuptoni suedisht apo anglisht, duhet të merrni me vete një person që mund të përkthejë për ju.

Është e rëndësishme që ne ta kuptojmë njëri-tjetrin, në mënyrë që ju të kuptoni të drejtat dhe detyrimet tuaja si klient, si dhe që ne të marrim përgjigje për pyetjet që kemi rreth jush dhe financave tuaja.

Pse ju nevojitet llogaria e bankës?

Të gjitha bankat suedeze janë detyrimin ligjor t'ju pyesin pse ju nevojitet të hapni llogari bankare dhe për mënyrën se si do ta përdorni llogarinë. Arsyeja mund të jetë për të depozituar pagën ose forma të tjera pagese, për të paguar qiranë ose si llogari kursimi.

Shumica e degëve tona nuk përpunojnë para të thata. Për këtë arsye duhet të pyesni bankën se si mund të tarifoni apo paguani përmes mënyrave të tjera përveç parave të thata.

Karta juaj bankare dhe informacioni i llogarisë suaj janë personale. Kartën ose llogarinë tuaj nuk duhet ta përdorin të tjerë. Është e rëndësishme që të tregoni kujdes me kartën dhe informacionin e llogarisë. Kini parasysh që asnjëherë të mos ia tregoni askujt kodin tuaj PIN.

Nëse ju nevojitet një pasqyrë llogarie nga banka për të marrë asistencë me të holla, duhet të paraqiteni pranë degës suaj më të afërt ku mund t'ju ndihmojnë të regjistroheni që të merrni falas çdo muaj pasqyrën e llogarisë nga banka.

E drejta për llogari banke

Të gjithë, pavarësisht nga nënshtetësia, kanë të drejtën themelore të hapin një llogari banke që mbulohet nga sigurimi i depozitave. Por, në disa raste banka ka të drejtën t'ju refuzojë hapjen e llogarisë. Banka nuk mund të hapë llogari për ju nëse:

- banka nuk është në gjendje t'ju identifikojë juve në mënyrë të sigurt
- banka konstaton se informacioni që keni paraqitur rreth arsyes që dëshironi të hapni llogarinë është i pamjaftueshëm

Ofertë mirëseardhjeje

Oferta jonë e mirëseardhjes ju mundëson të depozitoni të holla dhe të menaxhoni pagesat tuaja.

Kjo ofertë përfshin:

- Llogarinë bankare
- Kartën e bankës
- Shërbimin e pagesave



Nëse kuptoni suedisht ose anglisht dhe jeni në gjendje të përdorni shërbimet dixhitale, ne kemi edhe oferta të tjera. Flisni me bankën tuaj për ofertën që ju përshtatet më shumë.

Faktet

Rreth "Ligjit mbi masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"

Ligji mbi masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është një ligj suedez që synon të parandalojë që bankat të përdoren për evazion fiskal dhe financim të aktiviteteve kriminale. Ligji parashikon se banka nuk ka të drejtën të hapë llogari ose të kryejë transaksione nëse nuk kanë marrë përgjigje pse i nevojitet klientit llogaria dhe se si do të përdoret ajo.

Rreth sigurimit të depozitave

Suedia aplikon sigurimin e depozitave. Kjo do të thotë se klientët do të kompensohen, deri në një shumë të caktuar, nga shteti nëse banka falimenton.

Rreth parave të thata

Swedbank, bankat e kursimeve dhe shumë banka të tjera dhe grupe interesi, punojnë në mënyrë aktive për të reduktuar sasinë e parave të thata që qarkullon në shoqëri. Për këtë arsye, ne i inkurajojmë klientët tanë të përdorin kartat e pagesave, të tërheqin para të thata kur paguajnë me kartë në dyqane, të përdorin makineritë e depozitimit të parave të thata dhe ATM-të për depozitim dhe tërheqjen e parave të thata.